

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

Adem Zaplluzha

SONTE S'KA DASHURI

Shtëpia botuese -TREND- Prishtinë
2018

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

Redaktor:

Maxhun Osmanaj

Recensent:

Maxhun Osmanaj

Lektor:

Veli Velu

Ballina:

Bashkim Alushi

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

Adem Zaplluzha

SONTE S'KA DASHURI

Shtëpia botuese - TREND- Prishtinë
2017

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

Poezi e imazhit të dhembjes dhe dashurisë

Maxhun Osmanaj, shkrimtar

(prolog në vend të portretit : Adem Zaplluzha, maratonist shkrimor,krua i pa shtjerr)

Në sofrën e madhe të letërsisë, Adem Zaplluzha ka” shtruar ushqimin “ shpirtëror për lexuesit,për brezat që do ta kenë si dhuratë, si vlerë ideo-artistike. Me autorin në fjalë,pra, me poezinë e tij jam takuar në gazeta dhe revista shqiptare para katër dekadash. Ndërsa viteve të fundit edhe me librat e tij. Kur mësuam numrin e librave të botuara ,mbi 150-të vëllime, atëherë u ndodha përballë dy gjykimeve: cilësia e tyre dhe nga gjithë ai frymëzim?! Por duke i lexuar disa nga to na vizitoi një tjetër mendim që rrëzoi për tokë ndonjë dyshim apo mëdyshje për vëllimet e këtij krijuesi maratonist,një vullkan i pa ndalur shkrimi. Nëse një krijues do të kënaqet me ndonjë vëllim,Zaplluzha nuk hy në grupin e atyre që pas ndonjë botimi “fle” dhe pret diçka të re. Ky krijues me një energji të pa shtjerr duke u përballë me fenomenin jetë, shpalos gjithë atë mozaik të gërshetuar që kalëron në imagjinatën e tij të pasur nëpër kohë ,ku e djeshmja dhe e sotmja dominojnë mbi të nesërmen,por assesi të

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

jetë e nesërmja një dritare e mbyllur,por e lë hapur për interpretim dhe vlerësim. I përballur me rebelizmin e kohës, autori nxjerr nga miniera e shpirtit drithërimat, jehonën,pakënaqësitë dhe nervin nevralgjik të jetës përballë stuhive që ndeshet hero i lirik, ua dhuron lexuesve jo si imponim, por si ushqim ,që shuan shijen jo vetëm brenda një ditë ,por edhe me vite e dekada. Duke pasur një përvojë të gjatë krijimi,autori që në paraqitjen e tij të parë në “ Pionieri”(1957) guximshëm troket shtigjeve poetike që s'do të ndalet deri në ditët tona. Ai i ngjan një luftëtari kalorës, një maratonisti që s'di të ndalet, që s'di t'i nënshtrohet kohës, që s,'di t,'i nënshtrohet viteve që bart mbi shtatë dekada. Zaplluzha i prezantuar nëpër shumë antologji poetike,është edhe fitues i një mori çmimesh letrare nëpër manifestime letrare që vërteton një vlerësim dhe respekt nga të tjerët. Ai shënoi dhe shënon edhe sot kohën në rrjedhën e vet,plotëson me lirikat e tij të këndshme qoftë për fëmijë ,qoftë për të rritur. Po të shëtisim nëpër vëllimet poetike të botuara nëpër vite, ai korrespondon me një gjeografi temash,termash si : me atdheun,,letër atdheut, me Prekazin, hyji në Prekaz,,korrespondon fuqishëm në tabanin epik dhe lirik : me ashtin,gjakun,lotin,mallin,heshtjen,dashurinë,dh

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

embjen,nostalginë,njerëzit,,fëmijët,mërgimin,ve tminë,shekujt,shpresën,korrespondon me florënfau-nën:malet,mjegullën,myshqet,pemët,vesën,lej lekun, drurin,zogun,stinët, e çka tjetër nuk korrespondon autori?! Prandaj, duke komunikuar herë me gjuhën e ëmbël,, herë me gjuhën e “fortë”, herë fshikulluese , herë moralizuese,herë të butë, skofiare, herë rebele, ai të bë për vete si një magnet dhe nuk të lëshon aq lehtë.

“ Sonte s,ka dashuri “

(poezi)

Sapo të fillosh se lexuari dhe kur ta mbarosh,na vizitojnë dy imazhe të një përjetimi .Imazhin e dhembjes dhe imazhin e dashurisë, që mjeshtërisht kanë një ndërlidhje poetike duke e ruajtur poentën e tematikës dhe porosisë si kreacion poetik. Libri “Sonte s,ka dashuri “është i ndarë në tri cikle.: “ Thyhen hejet e degëve”, “ Fluturuan përballë vdekjes” dhe “ Sonte s,ka dashuri”.Ky libër poetik ,sa është prodhim-vlerë imagjinate aq është pasqyrë e një realiteti ku duket se autori sikur i kap skenat dhe aktet e përditshmërisë me armën e mendjes-kujtesës por edhe me syrin pishë duke ndriçuar nëpër kohë

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

gjithë atë peizazh të kohës. Duke lexuar një nga një çdo poezi , ato ruajnë një lidhje organike-poetike në kohë dhe hapësirë. Që në poezinë e parë “ Larg janë të mirët prej jush”autori tërheq vëmendjen për atë çfarë bëjnë disa, thua se një vëmendje e fshehtë ,por e nënkuptuar dhe prek sedrën,“Ju jeni krijesa të çuditshme,/ i keni hipur kalit prej druri “, pra shihet një dozë e fshikullimës dhe satirës ta themi,por që autori e ruan dinjitetin e heroit të përgjithshëm, nuk i ngarkon në vrasës:“ E di që nuk jeni vrasës /E as xhelat,/ Por gjithsesi jeni diçka / Mes jetës dhe gjijotinës.”Në këtë vëllim autori s’mund t’i ikë një kohë të rëndë -fantazmë, të egër ku paraqet :” Është dimër , kudo ngrirje shpirtërore”(Thonë se do të na vrasin), por vrasjet do t’i zëvendësojnë lindjet,ngase autori rrëfen në vargje: “ Një grua lindi binjakë”.Kështu hero i lirik-subjekti herë komunikon me botën e vet, herë mbetet zë i vetmuar,herë zë kumbues në mes qiellit,tokës dhe zotit. Në poezinë “ Poetët kurrë nuk vdesin” autori shpërfaq përmes poetit subjektin lirik të panënshtuar përballë aktit më të rëndë,vdekjes, kur ai kërkon krenar të mbetet ,krenar para kohës dhe nuk i përkulet “gjakatarit” të patheksuar,ngase poeti është zëri i kohës.

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

“ Mos më vrani
Se s’do të keni kohë
Më vritni
Që të mos pendohem nesër
Unë fare mire ju kuptoj
Po nuk më vratë sa ora ,do të çmendem”

Dashuria universale si udhërrëfyes është e pranishme aty këtu që e stolis tisin e shpirtit të horizontit krijues të autorit. Në gjeografinë e mendimit poetik,Zaplluzha shpërfaq muzën herë në vetën e parë, herë si fluturim imagjativ që derdhet si rreze mbi botën e njerëzve, në natyrë apo në universin e gjerave. Në shumë poezi dominon “piktura “ e dhembjes tragjike ku autori përmes ngjyrës së fjalëve,mendimit filozofiko-poetik na jap portretin e kohës së egër si p.sh. Te poezia”Nga prapashpina i dëgjuam” ku thotë: “ Nga prapashpina e dëgjuam Krakëllimat fantazmagorike te korbave”.Pra ,vëllimi “Sonte s,ka dashuri” mëton të jetë një vëllim i dhembjes, një pikturë tragjike e ngjyrosur me gjakun e krenarisë dhe dëshmi e gjallë,ku portretizohen nënat,fëmijët,gjaku,acari, korbat,fantazmat që qeshin ,hungërijnë sikur para një bishe trofe duke harruar se edhe ata(shqiptarët)janë qenie të tokës atërore,janë njerëz të kësaj toke shekullore të banuar historikisht. Këto tragjedi i ka pare Evropa,por

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

që bënte sehir tek popujt e vegjël ku autori shkruan”

“I pa se si shkuleshin gjallë foshnjat

Nga mitrat e përgjakura të nënave” (Kur Ballkani tinëzar)

Një tjetër klithje apo pyetje heroit lirik pyet Zotin:

“ O perëndi e rrejshme
Në emër të cilit Zot
Po i vranë fëmijët
Në barqet e nënave
Lumenj gjaqesh
Vërshuan kalldrëmeve ilire “

Në ciklin e dytë , autorin e vizitojnë edhe motivet e shtresuara sociale që si merimanga kanë përthekuar fatin e zyrtarëve të rinjve,papunësia,mosha e rëndë e pleqve,pra një peizazh i rëndë i jetës ku duke rrëmbyer një pjesë të realitetit të përditshëm përmes një gjuhe figurative arrin të ndërlidhë gjendjen që të dyshosh për një të nesërme me shpresëdhënëse ku “ Pastruesit e rrugëve, veç i lajnë pisllëqet e natës(kudo kontejner të boshatisur).

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

Skenat dhe aktet e luftës janë paraqitur me syrin dhe vëzhgimin e një rojtari besnik të kohës, ku autori përmes ironisë rrëfen tipa njerëzish dhe hy në shpirtin e disave që shpirti i tyre i helmuar nga egoja për pushtim “Ku në vend të dashurisë përqafton pushkën” Në ndonjë rast ka edhe ndonjë poezi deklarative, ku emri Evropë tingëllon edhe si rutinë e përditshme, ku autori nuk ka hy thellë në shpirtin e idesë, por paksa sipërfaqësore, por ,prapëseprapë nuk e zbejnë porosinë poetike., ngase na del fare mirë Evropa me kompleksitetin e fajtores dhe fatin e shqiptarëve, siç është poezia: “Koha është të mbyllen e jot ë hapen varret” . Por kur i bie në fund të kësaj poezie. prapë autori na befason me një ide kreative dhe estetike :

“ Koha është që sot o kurrë
Të lindë në Evropë një njeri
Që pështyn Neronin në surrat

Koha është të mbyllem e jot ë hapim varret” Pra, një përfundim mjaft i qëlluar dhe programatik. Rrëfimi poetik i Zaplluzhës kalon edhe në aspektin filozofik ku njerëzit e lindur , bëhen vrasës. Ku” Në shikim të pare/ U ngjajnë qengjave manarë/, Kurse në aktin e tretë të jetës/ Ua kalojnë egërsirave /Vrasin kur janë të

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

ngopur/Kurse te bishat ngjan e kundërta” .Kjo shihet në poezinë “ Pa i larë duart qahen të uritur”.Pra, epshet gjakpirësve të tyre për gjak nuk ngihen kurrë. Në rrëfimin poetik, autori shpesh i drejtohet heroit lirik me Ju(pra, në vetën shumës),ndërsa në disa poezi përdor figurën e mallkimit: “ Shkoni në djall të mallkuar”(fq. 38). Po të lexojmë poezinë”Ju të racës më të ulët njerëzore” shpalosim në betim të mashtruar të kryqalive, e të pabesëve ku thotë” U betuat në kryqin e juaj, të zi e katran e keni jetën”(fq. 41).Autori ua përmend karakterin dhe cilësitë e ulëta të armikut.

Cikli i tretë : “ Sonte s,ka dashuri” ku mban edhe titulli i vëllimit këtë emër, ndoshta është një cikël më i arrirë se dy ciklet e para, ngase aty bleron një mall i përvëlur, një dhembje, një etje, një dashuri,pra, një gërshetim idesh, ku dashuria është lajtmotiv kryesor, qoftë një dashuri personale,qoftë një dashuri që kalon në atë universale. Kjo dashuri na vjen herë si e ikur, herë si ëndërr e bukur, e ëndërruar, herë si kalorës nëpër beteja:” Dil dhe më prit të baladat e vjetra” (poezia, Mes nesh kishte vetëm një stinë), fq. 69) Pra kjo dashuri na del si një e shenjtë e ikur. Veshja poetike,indi poetik i erotizmit përthekon thuaja çdo poezi të këtij

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

cikli. “ Ju jeni AND-ja ime” (fq. 58)Duke përfunduar se lexuar këtë libër poetik, hetojmë tri kohë të shpirtit ,të heroit poetik: atë të djeshmes si dhembje e përvëlur, të sotmen si pa- kënaqësi dhe të nesërmen si ëndërr e papërfunduar, ndonëse në dy ciklet dominojnë tema-shumështresore , që kanë një lidhje poetike dhe gërshetim të natyrshëm. Pra , ky cikël sikur ruan një freski ,një frymë më të rrjedhshme ,një melodi shpirti që të mban më afër, ,të mbush më shumë shpirtin me ndjenja dhe emocione.

Figuracioni poetik i Zaplluzhës në këtë vëllim është mjaft i pasur me shprehje të reja që e stolisin mendimin poetik dhe nuk e rëndojnë idenë dhe porosinë ,Poeti në ndërtimin metrik është i lirë dhe shpeshherë nuk u qëndron parimeve konvencionale. Ai për ta shprehur rrëfimin poetik përdor që nga katërvargëshin , pesëvargëshin dhe gjashtëvargëshin , pra duke përdorë një vargëzim here-herë të lirë. Ndër figurat kryesore –letrare përdor krahasimin,metaforën dhe epitetin, ndonëse edhe ndonjë tjetër kalëron në vargjet e tij. Poezia e këtij vëllimi është një tablo,një imazh që shënon dhe ruan kohën si fenomen me gjithë atë gjeografi mendimi dhe emocioni, duke ruajtur një zë personal dhe kolektiv te popullit të vet.

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

Poezia e tij është tiktak i zemrës, drithërimë e shpirtit, kujtesë e kohës dhe popullit të vet...

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

**Cikli i parë
Thyhen hejet e degëve**

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

LARG JANË TË MIRAT PREJ JUSH

Ju jeni krijesa të çuditshme
I keni hipur kalit prej druri
Dhe s’ka sekush
Që mundet me ndal galopin e juaj.

Vraconi rrugëve të parrugë
Piskamat dhe britmat
Janë ngjizur për shpirtin e dërmuar
Kurse ju mendoni
Ose besoni se jeni mirë.

Larg janë të mirat prej jush
Mendoni diçka tjetër
Dhe thoni të kundërtën
E asaj që ju tjerë mendja .

E di që nuk jeni vrasës
E as xhelat
Por gjithsesi jeni diçka
Mes jetës dhe gijotinės .

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

Ju as vetë nuk dini
Se çfarë jeni
Në duar e mbani qivurin
Dhe këndon aleluja
Vetëm zëri i metaltë i erës
Mungon në shpirtin e juaj të shthurur.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

THANË SE DO TË NA VRASIN

Bryma e tejdukshme e mëngjesit
Ngjan me gjelin kryengritës
Që këndon mbi plehun e kujtesës
Kurse unë druaj
Se do të më vrasin
Në ditën e parë të festës së vezëve.

Është dimër, kudo ngrirje shpirtrash
Hejet janë përhapur
Si murtaja
Acari idhnak i kafshon çatitë
Nën një kulm mbuluar me kashtë thekre
Një grua lindi binjak.

Thanë se do të na vrasin
Nëse nuk këndojmë
Për herë të dytë këngën e tyre
Gjëja më e mirë që do të ishte
Lë të na pushkatojnë
Nën këtë lëkurë e grisur.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

MË DUKET SE KTHIM NUK KISHTE
PRAPA

Dikur vonë shumë vonë kuptuam
Se ku na dërgonin me trenin e mbrëmjes
I dëgjuam gjëmat e traversave
Shinat e metalta
Prodhonin një muzikë pikëlluese
Po ashtu të metaltë .

Më duket se kthim nuk kishte mbrapa
Askush nuk ka shpëtuar
Nga ai ferr i urrejtjes
Zëri i një violine
Vajtueshëm dëgjohej në largësi
Dëgjohej si zëri i kambanës së ndryshkur.

E vetmja rrugë që na kishte mbetur
Ishte ajo
Të pajtohem me vdekjen
Të cilën askush nuk e do
Por ja
Ndoshta fati i jonë ishte i tillë dhe pranuar.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

ISHTE NDALUR ORA NË MESNATË

Sot isha tepër i qetë shpirtërisht
Nuk e ngrita as zërin e lodhur
I shikoja delet kokulur
I shikoja se si shkonin drejt në thertore.

Përtej Urës së Gurit mbi qepenat e hapura
Binte një shi i dyshimtë
Stërkalat zgjateshin si litar samari
Dhe thyheshin mbi pragun e shkullur .

Thyheshin si gotat e kristalta kah mesi i natës
Kur çmendej kamerieri
Në pijetoren e kujtesës kishin vdekur fluturat
Ishte ndalur edhe ora në qepallat e errësirës.

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

NGA ZËRI IM ZBRITËN MJEGULLAT

Unë asnjëherë nuk eca deri në fund
Gjithmonë jam ndalur
Në gjysmën e parë të rrugës
Sa herë që desha të këndoja
Nga zëri im zbritën mjegullat.

Dimrat kurrë nuk më kanë pëlqyer
Gjithmonë e desha vetëm një stinë
E cila nuk ndodhej
Mes stinëve të vitit
Por askush nuk ua dinte emrat.

Një mëngjes kur u zgjova
Asnjë këndes nuk pashë mbi tra
Kishin ikur edhe lejlekët
Ishte dita e parë në jetën time
Të cilën nuk e desha asnjëherë.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

U NGRINË EDHE GURËT

Datat nuk i mbaj në mend
Nuk di athua ishte luftë
Ose një përzierje
Mes luftës dhe pages
Por ishte diçka e tillë
Që s'dallohej në asnjë mënyrë.

Lumi u ngri atë dimër
U ngrinë edhe gurët
Një peshk me një violinë
Qëndronte në bregun e kujtesës
Era nuk e ndalte këngën e acarit.

Më thanë pjalmonte një borë e zezë atë ditë
Por unë nuk pashë asnjë ndryshim
Vetën më thanë
Asgjë më shumë nuk di
Përpos që këmishën e kisha të lagur.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

POETËT KURRË NUK VDESIN

Po ju them për të tretën herë
Ju mund të më pushkatoni
Të ma vendosni kokën në gijotinë
Por mos harroni
Se poetët kurrë nuk vdesin.

Përqafuni sa më fort me kondakun
E pushkës së juaj
Lë të jetë përqafim i vdekjes
Se nesër
Askush nuk e di se ku do të jeni.

Shikoni vetveten në pasqyrë
Shikoni se si duken të vdekurit
Nga sytë e juaj të çakërdisur
Nuk buron drita
Por një sterrë e paparë dhe e padëgjuar.

Mos u vononi se s'do të keni kohë
Më vritni
Që të mos pendoheni nesër
Unë fare mirë ju kuptoj
Po nuk më vratë sa ora, do të çmendeni.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

DETET E KËSAJ BOTE TË SHTHURUR

Ju jeni një tjetër lloj krijesash
Duart e juaja të shkurta
U ngjajnë të vdekurve kur ngrihen
E shndërrohen
Në një copë kallkani.

Ose bëhen si kërcu i kalbur mali
Para se të varrosen heshtin
Kurse pranë varrit
U ngjajnë egërsirave
Në shtatë qiej iu dëgjohen ulërimat.

Ndoshta as ju nuk e njihni vetveten
Ose s'doni të kuptoni
Nga lotët e juaj të kripur
Buçasin si në jerm
Detet e kësaj bote të shthurur .

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

PIKONTE NJË DIMËR I ACARTË

Ajo nuk ishte në intervalet e njëjta
Me dashurinë e saj
Një ditë jetonte në Jug
Kurse ditën tjetër në Veri
I kruante shpatullat si ariu polar.

Sa herë që kishte etje
I lëpinte
Çmendurisht i lëpinte kallkanët
Nga buzët e saja të holla
Pikonte një dimër i acartë.

Andaj gjithmonë dukej e tillë
Mbi shkëmbinj prej akulli
Qëndronte si sfinksi i shkretëtirës
Dhe i krihte deri në mbrëmje
Flokët e thinjura të trishtimit.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

JANË DEHUR RRËNJËT E PJERGULLAVE

,

Sonte deri në mëngjes
Do të këndojmë
Kur arrin dita e shurdhtë
Do t'i mbyllim qepenat e dyqaneve
Për ta dëgjuar
Atë këngë të lashtë të këpucëve.

Në rrugën e kazanxhinjve
Do t,i kallajisim
Të gjitha tenxheret
Dhe kusitë prej bakri
Vjeshta sa nuk ka trokitur
Te tinarët e mbushur me verë.

Më thanë se sivjet është koha e dasmave
Nga një kokërr rrushi kuptova
Se mushti i sivjetshëm
Ka një shije fantastike
Të dashurisë
Sa që nën çatitë e shtëpive
Janë dehur rrënjët e pjergullave.

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

AJO MBI NJË KEP PREJ AKULLI

Mbrëmë ishin ndezur
Të gjitha dritat në qytet
Asnjë fanar
S’e kishte shkyçur kujtesën
Ishte një natë hyjnore
Sa që yjet i kalëronin meteorët endacakë.

Ajo mbi një kep prej akulli
U ngjante sirenave të Uliksit
Endte një lloj mëndafshi
Që nuk është parë asnjëherë
Në brigjet e Jonit idhnak
Mëndafsh i ardhur nga Kina e largët.

Njëmijë e një desh të bardhë
U therën
Brenda një nate
Kazanët ishin larë me kallaj të bardhë
Te rrapet e lagjes
Njëmijë e një net nuk pushuan daullet.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

FJALËT JANË TË TEPËRTA SONTE

T'i lëmë fjalët për ndonjë tjetër rast
Ne njëqind vjet biseduam
Dhe askund nuk mbërrimë
Lëre pra
Lë të flasin duart tona.

Kush e njih më mirë gjuhën e dashurisë
Se sa buzët dhe duart
Ne kot po flasim
Kjo bisedë i ngjan një monotonie
Sa të dhembshme po aq trishtuese.

T'i lëmë fjalët rehat
Të gjejmë për duart dhe buzët tona
Një tjetër punë më të mençur
Fjalët janë të tepërta sonte
Derisa me kaq mrekulli bisedojnë duart tona.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

DRURËT I KËRCASIN DHËMBËT

Nga kjo shembje e mistershme e malit
Po shqimen llambat e lisave
Drurët si njerëzit në dy gjunjë
Nuk mund t'i bëjnë
Ballë acarit
Kurse dielli i ngrirë ka një qeshje misterioze.

Asnjë bareshë nuk mbeti në stane
Ikën edhe oqiçët
Trinat mbetën të shkreta
Ku asgjë nuk dëgjohet
As nuk shihet
Përpos ulërimave të egra të ujqërve.

E bora e kristaltë dhe e trishtuar
Pjalmon mbi pullazet e mbuluara
Me kashtë thekre
Drurëve u kërcasin dhëmbët
Nën rrënjë dëgjohej ofshamat
S'prajnë as piskamat e gjetheve të shkundura.

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

U PËRNGJAJNË LEJLEKËVE TË SËMURË

Një nga një kanë filluar
Të vdesin qytetet
Sa të dhimbshme qenkan
Këto vaje të çative.

Oxhaqet duken si gjysmë harqe
Të përkulura deri në tokë
Më duket se nuk kanë forcë
Të qëndrojnë në këmbë.

U përngjajnë lejlekëve të sëmurë
E breshëri i egër
Troket në dritaret pa xhama
Troket në ndërgjegjen e njerëzimit.

Një stinë si kjo nuk pashë asnjëherë
I kalova gati shtatëdhjetë e katër dimra
Por kësi acari ndjenjash
Ende s’përjetova deri më sot.

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

KOPSHTI DUKEJ LAKURIQ

Nuk është kjo natë e parë
Që më duket aq e sterrët
Kam parë edhe net të tjera
Se si ballafaqoheshin me mjegullat
Ishte vjeshtë e vonë
Kur veç ishin shkundur ftonjtë.

Posa dola në qytet
Rrugët ishin të boshatisura
Dukeshin si kungujt e kalbur
Minjtë e fushës ua mësyn gjirizeve
Dhe kurrë më
Nuk dolën nga ato katakombe.

Kishte kohë që ishin shkundur pemët
Kopshti dukej lakuriq
Mbase ishte koha e fundit
Që të ia veshim pallton e zezë
Dimri dukej aq afër
Sa që ngriheshin yjet në qiell.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

ISHTE SHTRIRË NË DJEPIN TIM

U befasova deri në çmendi
Kur kuptova
Se nata
Ishte shtrirë në djepin tim
Dhe si një kërthi flinte e lidhur
Ndoshta për herë të parë.

Sa di unë netët kurrë nuk flenë
Dhe ngjau ajo që duhet të ndodhte
Nëpër lagjet e evgjitëve
I dëgjuam britmat
E njerëzve të dehur
Mbase një hije kishte bërë vetëvrasje.

Më kujtohen ato kohëra
Kur i takonim ditët e uritura
Nga rropullitë i nxirrnim zorrët
Dhe ua jepnim qenve të uritur
Vetëm atëherë ishim në gjendje
Të flemë pakës në qetësi.

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

NË BALLINËN PERËNDIMORE

Luvri dukej si një gjigant klasik
Me një gojë të madhe
Sa herë që merrte frymë
Herë hapeshin
E herë mbylleshin dritaret.

Në ballinën perëndimore
Ku ishin varur nëpër muret e verdha
Heronjtë e vdekur të Olimp
Kornizat e piktorëve surrealist
Dukeshin më madhështore se perënditë.

Nxora nga xhepi i majtë shaminë
Ta pastroj fytyrën e një ikone
Sa ora mu afruan dy hije të murrme
Sa që shaminë ma gozhduan
Si Krishtin pranë ikonave të përgjumura.

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

OSE VENDOSIN AFISHE

Diku nëpër lagjet e qytetit
Me brusha plastike njerëzit i ngjyrosnin muret
Vetëm me ngjyra të verdha
Ose vendosnin afishe
Mbi ngjyrat e vendosura që më parë.

Një palë i vendos tinëzisht
Kurse pala tjetër i zhvendos
Në ndonjë kënd tjetër të qyteti
Kështu në këtë mënyrë bizare
Të gjitha ngjyrat i ndërrojnë vendet.

Kur e ndjejnë lodhjen
Ulen në stolin e parë të kafenesë
Ose të ndonjë pijetore të dorës së dytë
Dhe bëhen tapë nga dehja
E afisheve të vendosura mbi afishe.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

NGJAJNË ME ZËRIN E NATËS

.

Duke shkelur mbi syprinën e sterrës
Pëshpëritin me zë të lartë
Ose këndojnë që sa më larg
Të dëgjohet artikulimi pa ngjyrë
Në boshllëkun e zërit të natës.

Më pastaj si nëpër ëndrra
Në ecje e sipër i numërojnë
Dështimet e ditës
Ato të mbrëmjeve nuk i përmendin asnjëherë
Kam përshtypjen se nuk e donë të vërtetën.

Të nesërmen me tërë forcën e bindjes
Mendojnë se ia arritën qëllimit
Dhe në gjoksin e secilit
Hapet nga një zgërbonjë prej mishi
Kurse pema e tyre vjen duke u tharë .

Prishtinë 12 janar 2017

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

THYHESHIN HEJET E DEGËVE

Majat e ushtave ishin lakuriqe
Nga të ftohtit
Dridheshin si purtektë të çeliktë
Ishte një dimër i acartë
Nëpër dej ngrihej gjaku i përhitur.

Ky dimër asnjëherë me kaq ashpërsi
Nuk ka zbritur në tokën tonë
I pamë pemët e ngrira
Nga zgërbonjat e trungjeve qindvjeçarë
Thyheshin hejet e degëve.

Dheu i ngrirë kush e di
Se si do të duket në pranverë
Gjelbërimi ka marrë një ngjyrë menekshe
Nga lotët e ngrira të shkëmbit
Si rrëshira e zezë kullojnë plagët.

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

NGA PRAPASHPINA I DËGJUAM

Ishim mes njerëzve
Kur zjarri i verdhë filloi
T’i lëpinte
Buzët e fishkura të çatisë.

Oxhaqet me vështirësi i rezistonin
Shembjes
Nga prapashpina i dëgjuam
Krakëllimat fantazmagorike të korbave.

I dëgjuam edhe ulërimat
Në këtë llahtari varrosej shpirti i njeriut
Vajet na dukeshin në ato çaste
Si një muzikë e lehtë.

Çfarë nuk pamë atë ditë te muranat
Nga secili gur i rrënuar
Çurgonte një lloj gjaku
I paparë në këto anë deri më sot.

Dukur vonë nga qielli i sterrët
Ra një heshtje e tunxhtë
Ishte hera e parë që në jetën time
Pashë se si nga kolonadat kullon gjaku i zi.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

KUR BALLKANI TINËZAR

Më kujtohet ora dhe dita
Kur Ballkani tinëzar
E veshi këmishën e urrejtjes
Evropa naive
Ishte në gjendje
Të besoj çdo fjale
E gënjeshtre të trilluar

Ndoshta i shkonte për shtati
Të krijohet një histori
E tillë mashtruese
Një pjesë e popullit
Sytë i drejtonte kah perëndimi
Kurse pjesa tjetër
Ëndërronte Azinë

Nga frika nënat dështonin
Ose lindnin fëmijë të gjymtuar
Nuk di
Kujt t'i bëjë zë
Kur e tërë Evropa i pa këto masakra
I pa se si shkuleshin gjallë foshnjat
Nga mitrat e përgjakura të nënave

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

NË EMËR TË CILIT ZOT

Juve po ju pyes
O perëndi të rrejshëm
Në emër të cilit Zot
Po i vrani fëmijët
Në barqet e nënave
Lumenj gjaqesh
Vërshuan kalldrëmeve ilire

Nuk di a jeni njerëz
Apo krijesa të shthurura në mendje
Si mund të vriten të pafajshmit
Çfarë po ju pengojnë djepat
Po ju pyes
Në emër të cilit Zot
Po nakatoset pafajësia

Ejani në vete o krijesa
Të shëmtuara
Visheni pallton e zezë të stinës
Sa të zi jeni
Kur nga pafajësia ndërtoni
Fronin e juaj të pistë
Prishtinë, 13 janar 2017

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

**Cikli i dytë
Fluturuan përballë vdekjes**

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

KUDO KONTEJNER TË BOSHATISUR

Rrugëve pa emër dhe mbiemër
Dehen të rinjtë
Me mjekra të thinjura
Pleqtë iu drejtohen Parajsës
Mbase kanë vendosur të ikin nga ky Ferr

Kudo kontejner të boshatisur
Trotuaret e zbrazëta
Duken si alet e kujtesës
Ku bredhin njerëzit pa shtëpi
Bredhin me nga një shishe në xhep

Dikur vonë drurët e dehur
Zhdehen nga një mall i pashuar
Kur fillon të zbardh agullima
Pastruesit e rrugëve
Veç i lajnë pisllëqet e natës

Një grua me këmbë si kallami i fishkur
Kalamendet prej një ane
Në anën tjetër të trotuarit
Pas saj
S'pushojnë se ngarenduri qentë endacakë

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

PRANË JUSH ZGËRDHESHEJ ERRËSIRA

Ju ikët mbrëmë kah sytë këmbët
Më duket se ju trembi
Muzika e mitralozit
Ajo muzikë e metaltë
E cila dëgjohet çdo pesëdhjetë vjet

Pashë kur e morët rrugën e varreve
Njëri me një gotë verë
Kurse tjetri mbante në xhep
Shishen me raki rrushi
Pranë jush zgërdheshej errësira

Ju nuk kishit përse të flisni
Ishit dezertorë
Në shpirtin e juaj kishte vdekur atdheu
Vetëm pjergulla e kuqe
I ngjante një nuseje pa duvak

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

E GRATË KUJDESEN PËR USHQIMIN E
QENVE

Nga këtu ku jam
Shoh Evropën si një kokërr fasule
Ushtarët duke drekuar me oreks
Lakra të ngrira
Kazanëve u vinte era e mishit të ngordhur

Nëpër metropole duken vetëm zonjat
Duke i shëtitur qentë
Shëtisin edhe ato
Me nga një rrip ekstravagant në bel
Nëpër kafenetë pleqtë lozin shah

Asnjë lajm nga lufta
Lidhjet telefonike në defekt
Kurse pëllumbat dhe skifterët
Nuk sjellin më letra
E gratë kujdesen për ushqimin e qenve

Më thanë se më shtrenjtë kushton
Një konservë mishi për qentë
Se sa jeta e një ushtari
I cili diku në rrojën e mortit
Në vend të dashurës përqafon pushkën

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

KOHA ËSHTË TË MBYLLEN E JO TË
HAPEN VARRET

Ah moj Evropë dinake
Sa pak ke ndryshuar
Kush e di
Se çfarë gjelle po zihet
Nëpër kancelarit e urrejtjes

Për çdo ditë në shpirtin tënd
Po lind nga një zjarrvënës
Po lindin djajtë
Me pamje
Të rrejshëm prej engjëlli

Kudo nëpër rrugë
Shoh vdekje njerëzish
Nga muzikat e mitralozave
As në djep
Nuk mund të rehatohen fëmijët

Kurrë nuk pat rehati
Kjo fushë e mjerë e mëllenjave
Gjithmonë gjendej një vashë
Me një shtambë prej deltime
Që ua shuante etjet ushtarëve

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

Koha është që sot o kurrë
Të lindi në Evropë një njeri
Që e pështynë Neronin në surrat
Koha është
Të mbyllen e jo të hapen varret

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

NJERËZIT SI GLADIATORËT MODERN

Sa e sa masakra përjetoj kjo botë
Gladiatorësh
Arenat e përgjakura
I dëgjuan britmat e të uriturve
Ulërimat e ujqërve depërtuan thellë
Në vetëdijen tonë të sëmurë

Ishin kohërat kur nuk dinim
Se kush jemi sot
E kush do të jemi nesër
Nuk na u deshtë shumë
Që t'u përngjajmë kanibalëve
Sa që për pak desh e hamë njëri- tjetrin

Njoh njerëz që pa dëshirën e tyre
I përjetuan dy luftëra botërore
E qindra të tjera
Mes shteteve
Njerëzit si gladiatorët modernë
Vranë e kafshuan llojin e vet

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

.PA I LARË DUART ÇOHEN TË URRITUR

Nuk di kur do të kuptojmë
Se bota është një arenë
Ku lindin dhe vdesin vrasësit
Sillen e rrotullohen
Në një rreth magjik
Deri në asgjësimin e sojit të vet

Në shikim të parë
U ngjajnë qengjave manarë
Kurse në aktin e tretë të jetës
Ua kalojnë egërsirave
Vrasin kur janë të ngopur ose të dehur
Kurse te bishat ngjan e kundërta

Asnjëherë nuk e mësuan
Ose nuk e kërkuan arsyen
E të bëmave të tyre
Sa herë që ulen pranë tavolinës së ushqimit
Nëpër pjata shohin gjymtyrë njerëzish
Pa i larë duart çohen të uritur

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

SI ÇADRAT NË FUSHËN E MËLLENJAVE

Ato pak zëra që kishin mbetur
Në paradhomë
Dolën nëpër korridore
Dhe si kuajt e egër
I thyen xhamat e dritareve

Jashtë binte një shi i përllloçur
Mbase ishte i lodhur
Nga një udhëtim i gjatë planetar
Kthehej ashtu siç kthehen lejlekët
Në pranverën e hershme

Pemët në kopsht dukeshin
Si çadrat në fushën e mëllenjave
Zë njeriu nuk dëgjohej
Gjethet e shkundura në vjeshtë
Tani më duken të kalbura

Vetëm nëpër dhomat e errëta
Vazot e kristalta
Kanë filluar të çelin disa lloje lulesh
Ndoshta ishin prej plastike
Ose të ngjyrosura me dhembjen e dimrit

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

MOS HARRONI SE FERRI I JUAJ

Ju jeni mashtrues
Njerëz pa fije yndyre në fytyrë
Sa herë që shikoj më mirë
Më duket se u shëmbëlleni
Bijve të Satanës

Ikni nga erdhët
Nuk kemi nevojë për ju
Neve na mjafton ky ferr i jonë
Jeni njerëz apo djajtë e ndonjë planeti
Që çdo mëngjes pështyni pasqyrën e juaj

Largohuni ju thashë
Shkoni në djall të mallkuar
Mos harroni se ferri i juaj
Është disa herë më i zi ky i yni
Ferri ku zihen e përvëlohen djajtë e mallkuar

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

MASHTRUESIT E TË GJITHA LLOJEVE

Mes turmës çfarë nuk panë sytë
Engjëj të veshur
Me pallto të zeza
Djaj në formë engjëlli
Njerëz që nuk ngjanin me asgjë
Mbanin në kokë ca kapela të zeza

Mashtrues të të gjitha llojeve
Kalonin në heshtje mortore
Me nga një flakadan të ndezur
Dukeshin si priftërinjtë e ferrit
Nga qeshja e tyre misterioze
Derdhej lumi i çmendur i urrejtjes

Një murg i moshuar mezi
I mbante mbi shpatullat e lodhura
Vitet që kishin ikur pa asnjë shpresë
Kurse në arenën e qytetit
Gladiatorët modern
Luanin si të babëzitur një muzikë të metaltë

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

Në kokën time të dërmuar e të lodhur
Si fasulja në vorbë
Zihej e kaluara e dyshuar
Kjo turmë fallxhoresh
Shikonte me habi cepat e kryqit
Shikonte kah gjakosej si asnjëherë më parë
Toka e përvuajtur e atdheut tim

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

U BETUAT NË KRYQIN E JUAJ

Me tërë forcën e zërit
Vikas e këlthas
Mashtrues të pabesë
Ju jeni si kali i drunjtë Trojës
Depërtuat thellë në zemrën e kalasë
Dhe nga brenda e zaptuat

Ju thashë se jeni horra
Vejusha të gjinisë mashkullore
Si tregtarët e pabesë
I fërkonin duart e mashtrimit
Ju të racës më të ulët njerëzore
Me tradhti na i zhyet portat

U betuat në kryqin
Dhe në Zotin e juaj
Të cilin me qindra herë
E përdhosni në ditë
Ju faqezinjtë e kësaj dynjaje
Të zezë e katran e patët jetën

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

MALLKIMI

Sa do të doja të isha prift
Ose murg
Sa shumë do dëshiroja
Të di të mallkoj farën dhe fisin e juaj

Por ja që kam qëlluar një njeri
I cili s’di të shaj si ju
E të mallkoj
He ju mallkoftë i madhi Zot

Prishtinë, 14 janar 2017

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

KURSE NËPËR LLAGËME SI DRU DIMRI

Bosfori dinak si skilja e shkretëtirës
Shikonte kah qoheshin dallgët
Ngjiteshin përpjetë mbi shtatë pash
Shën Sofia e përgjumur
Në grykat e topave i numëronte qivuret

Ushtarët me nga në peksimet
E mbanin gjallë shpirtin
Kishte edhe prej tanëve në atë masakër
Burra naiv
Që vdisnin si me le për dovetin

Gryka e Bosforit
Si në ankth këndonte këngën
E saj të vjetër Çanakala mrena
Ku në vend të xhephanes
Ushtarëve u dërgonin kundra e nallane

Kurse nëpër llagëme si dru dimri
Stivoheshin të vdekurit
Thonë se një arnaut me një sy të verbër
I qëllonte oxhaqet e vaporëve të luftës
Derisa vdekja fundosej me gjemitë e carit

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

PËRPOS LEHJES SË EGËR TË YJEVE

Një ushtar pëshpëriste në ëndërr
Këtu nuk ka vdekje
Nën qiellin e mërrolur
Retë u kanë hipur kuajve të egër të luftës
Dhe i kalërojnë arkivolet

Pranë varreve hapen varre të reja
Diku me kryq e diku tjetër
Veç i bashkojnë dy copa druri
Dhe formojnë një lloj kryqi
Që aspak nuk i ngjan kryqit

Dheu i murrme i mbulon me frikë
Eshtrat e një kohe
Te plepishtat asgjë s'dëgjohet
Përpos lehjes së egër të meteorëve
Mbi varka të përgjumura udhëtojnë yjet

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

SI SHPIRTI DHE DASHURIA E JUAJ

Nëpër qiell si copëza të thyera yjesh
Fluturojnë shrapnelat
Për pak dritë e diell
Kam nevojë sonte

T’i shkruaj dy letra
Nënës sime
Dhe të dashurës
Në frontin jugor të atdheut

Që të dy letrat
Domosdo do të jenë të njëjta
Do ua shkruaj nëse nuk kthehem
Mbi varrin tim nuk dua lot

Unë jam në ballë të atdheut
Si shpirti dhe dashuria e juaj
Më ngroh sonte
Kondaku madhështor i mitralozit

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

RRAPI KRYENEÇ SI GJITHMONË

Ky lis e kjo zgërbonjë
Më shikojnë me sy të turbullt
Nga çatitë vjellin fishekzjarrët
Pak dritë më duhet sonte
Të ja shoh sytë e errësirës

Një krismë e befasishme
I trembi kukuvajkat
Asnjë zog klandestin
Nuk mbeti pa u trembur
Që flinin në degët e gështenjave

Hëna lakuriqe pa u turpëruar
I lante gjinjtë
Me pluhurin e shkundur
Të mjegullave të përhitura
Jashtë në bahçe u zgjuan pemët

U zgjuan për së dyti jerm
Dhe kurrë më nuk i zuri gjumi
I shkundëm edhe rrënjët
Rrapi kryeneç si gjithmonë
Nuk e ndalte ison e këngëve të lirisë

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

ASGJË TJETËR NUK NA DUHET

Është natë
Jemi pak veta
Duhet të ecim me kujdes
Po edhe ashtu
Shumë pak hapësirë na duhet
Ta sulmojmë armikun

Nuk është guximi në numër
Por në shpirt
Ne duam dhe mundemi
Të shpërthejmë këtë errësirë
Sa më pak të jemi
Aq më pak ka vend për plumbat

Asgjë tjetër nuk na duhet
Në këtë natë të sterrët
Të bashkohemi me errësirën
Dhe t'i zëmë në befasi
Armiqtë e dehur nga frika
T'i mësymë që tani e t'i hallakasim

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

NËN KËMBËT E USHTARËVE

Sonte shoh vetëm korba
Dhe errësirë
Hëna e paska humbur rrugën
Kjo moçalishte
Dikur ishte një luadh këndeje pari

Ju thashë se nuk shihet asgjë
Gishtat me na i ngulitur në sy
S’dallohët ana e kundërt e rrugës
Nuk ndriçojnë as yjet
Tmerrshëm gjëmojnë anijet e fundosura

Nata qenka e frikshme
S’dëgjohen as britmat e kukuvajkave
Manat e egra i përkund stuhia
Nën këmbët e ushtarëve
Si një muzikë e lashtë kërcëllon dëbora

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

NUK I BIE NË DORË TË ASKUJT

Pylli i zi katran
Përtej pyllit errësira
Anijet e fundosura gjëmojnë
Si i sëmuri i Bosforit
Në Itali Piza rrufit kafënë e mëngjesit

Asgjë e re s’po ndodh
Në Ballkanin tinëzar e të çmendur
Gjethet e fishkura të vjeshtës
Ka kohë që kanë rënë në tokë
Por Kruja qëndron në këmbët e veta

Flitet se ra Kostandinopoja
Pak më vonë u dorëzua edhe Berlioni
Por Kruja e Gjergjit
Me krenari shikon Adriatikun
Nuk i bie në dorë të askujt

Do gjunjëzohet edhe Athina
Këtë fat do e përjetojnë shumë metropole
Ra dynjaja në dy gjunjë
Po bien edhe perëndit e shthurur
Por Kruja s’bie në dorë të askujt

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

THIRRMAT E ATDHEUT PËR LUFTË

Heshtje mortore
Vetëm psalmet e lashta të murgjve
Vajtueshëm dëgjohen sonte
Njerëzit kokulur kalojnë pa zë

Mos vallë ka vdekur atdheu
Për çfarë janë veshur
Burra në zi
Kënd po e varrosin sonte

Sërish kush e di se për të satën herë
Po dëgjohet një kukuvajkë
Si një gjëmë e trishtuar
Dëgjohen zërat prapa maleve

Thirrmat e atdheu në luftë
Dëgjohen edhe përpëlitjet e tokës
Nga kjo gjëmë e keqe
Po lind një hata e re

Prapa shpine buzëqeshje malesh
Lëvizjen gurësh nën rrënjë
Si një perëndi prej legjende
Po ngritët atdheu në këmbë

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

Po ngritët deri në qiell
Si perëndit e ringjallur
Për të mos rënë kurrë më
Nga larg dëgjohen thirrmat e djemurisë

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

PO NA NGUFAT KJO LAKURIQËSI

Deri në asht është zhveshur toka
Duket lakuriqe nga krismat
Zjarret e mitralozave nuk prajnë
S’prajnë as britmat e fëmijëve
Kjo stinë e vdekjes
Po i shqyen lisat në dysh

Edhe drurët qenkan zhveshur si njerëzit
Kudo kufoma njerëzish
Dhe ngordhësira kafshësh
Kush i vrau qentë dhe macet e rrugëve
Mos vallë uria e bëri këtë kërdi
Dhe vrau çfarë i doli përpara

Çdo gjë lakuriqe cip cullak
Si jeta
Edhe të vdekurit s’kemi
Se me çfarë t’i mbulojmë
Kjo zhveshje shpirtërore
Po vuan nga ethet e lakuriqësisë

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

DUKESHIN LAKURIQ SI ZOGJTË E
NGRIRË

Nuk kemi më durim
Mbi shpirtin tonë po pluskojnë dhembjet
Në gjoksin e drurit të njomë
Po hapet si krater
Një zgërbonjë e paparë

Si të durohen goditjet e shirave
Kjo furtunë
Që po na mbytë në heshtje
Nga ndjenjat tona të dërmuara
Po i shkulë të gjitha shpresat

Breshëri i mbrëmshëm
I theu tjegullat e të gjitha kohërave
Kulmet e shembura
Dukeshin lakuriq si zogjtë e ngrirë
Dhe kurrë më nuk u dolën pendlat

Dhe sërish një shi i trentë
Binte rrugëve të çara nga shrapnelat
Acari kafshonte tmerrësisht
Kafshonte si gjarpri i zi
Ashtin e pathyeshëm të drurit në lëndinë

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

NJERIU GJITHMONË ECËN

Njeriu gjithmonë ecën
Në disa drejtime
Kalon rrugëve dhe monopateve
Duke depërtuar shtigjeve të pa përballuara
Ecën nëpër një dimër kur bie borë
Kalon edhe nëpër stinët e tjera

Kjo është natyra hulumtuese e njeriut
Për të mbërri në arktik
Duhet t’i kaloj të gjitha shkretëtirat
Të luftoj me ariun Polar
Dhe sërish e sërish
Të dal fitimtar në arenën e jetës

Njeriu gjithmonë ecën
Në kundërshtim me erën
Si luan u bënë ballë luftërave
Vetë jeta është një luftë
Të cilës nuk guxon t’i dorëzohet
Asnjë njeri deri sa merr frymë

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

IMAZHET E IKJES ISHIN TRISHTUESE

Ajri dendur pëlçet si kripa në zjarr
Pëlçet prej një rrebeshi plumbash
Nga istikamin i tretë
Del një ushtar
Duke shpalosur gjoksin e çeliktë
I prite plumbat vrastarë

Shiu i vdekjes nuk men
Po bien çunat për nder të atdheut
Po bien me plumb në ballë
Sa që armiqtë i zuri paniku
I braktisën armët
Dhe e morën arratinë kah sytë këmbët

Imazhet e ikjes ishin trishtuese
Aq më trishtim
Bartnin britmat e ikanakëve
Kurse djelmoshat e atdheut dhe tytë e tyre
Me krenari këndonin këngën
Kaçanik he të raft pika

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

FLUTURUAN PËRBALLË VDEKJES

Nuk na lënë asnjë rrugë tjetër
Me dhunë na i mbyllën
Të gjitha shtigjet
Na u deshtë t’i ndezim zjarret
Sot o kurrë
T’i dalim Zot atdheut

Dhe i dolëm ashtin siç dilyn
Baballarët tanë
Me nga një gjysmë pushke
I ndezëm zjarret
Dhe kurrë më nuk u shqimën
Derisa e pamë dritën me sy

Njerëzve të dinjitetshëm
Gjithmonë u vijnë miqtë në ndihmë
Dhe na erdhën duke fluturuar
Zogjtë e çeliktë
Për t[ë mbërritur deri te portat e lirisë
Fluturuan përballë vdekjes

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

MARSHOJMË PA SHOLLA NËPËR
ERRËSIRË

Sonte nuk ndalen britmat e predhave
Skuadrat e vdekjes
Nëpër moçalet e mendjes
I lajnë duart e pista

Një pemë e moçme
Disa ditë me radhë vajton fatin e gjetheve
Në trastën e mikut tim
Ishte ngrirë dora e djathtë e një ushtari

Ky acarë i paparë
Përfundimisht po do me na çmend
Na i ngriu edhe këpucët
Marshojmë pa sholla nëpër errësi

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

NUK DUA VDEKJE MË TË BUKUR

Më në fund u dorëzuan
Me këto duar të mishta
I preka bateritë e ikanakëve
Metali i akullt
Kundërmonte marihuanë

Asgjë më pak s’kundërmonte
As toka e djegur
Prej grykës së skuqur të një mitralozi
Dheut i vinte era vdekje
Çdo gjë atë ditë ngjante me qivurin tim

Dhe ia dolëm ta mposhtim
Të pamposhturin
Nga pas pashë disa xixa zjarresh
I pashë potkonjtë e skuqur
Të ngordhësirave në ikje

Nëse duhet le të vdesi sonte
Nuk dua vdekje me të bukur
Se sa kjo kënaqësi që mu afrua
Të shoh ikjen cerberëve
Iknin me nga një trastë nën sqetull

Prishtinë, 15 janar 2017

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

URIA PO I GËRRYEN MURET E MENDJES

Nga zjarri shkatërrues si ariu polar
Mbeta duke i lëpirë plagët
Me sytë e mi pashë
Plasaritjen e tokës
Si një nënë e moshuar
Pemët vajtonin dhembjen time

Qante dhe rrapi i ndarë në dy pjesë
Zjarret e shrapnelave
Sivjet i kositën edhe luadhet e pakositura
Thanë se nuk do të këtë më uri
Po si ta përtypi o vëlla
Këtë copë bukë të përgjakur

Uria po i gërryen muret e mendjes
Një sëmundje e pashëruar
Paska hyrë mes nesh
Ushtarët dezertorë ndëshkojnë njëri-tjetrin
Kurse murrilani kurrë nuk pushoi
Mbi tokën tonë të plasaritur

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

NDIZNI JU LUTEM TË GJITHA LLAMBAT

Nuk kam më forcë që t'i dëgjoj
Thashethemet e juaja
Koha është të arratisem
Te yjet
Atje ku ndizen çdo natë
Dritat inkandeshente të kujtesës

Kjo luftë më bëri ta harroj vetveten
Nuk di se ku i lashë duart
Nën degët e cilës pemë
E vara kondakun e thyer
Sepse më bindën miqtë
Luftë nuk do të ketë më

Ndizni ju lutem të gjitha llambat
E kaltërsisë së qiellit
Ta shoh mirë udhën deri te drita
Dua të shikoj përtej çdo mundësie
T'i shoh sytë e shpresës
Se me çfarë madhështie e ndriçojnë tokën

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

**Cikli i tretë
Sonte s’ka dashuri**

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

GJENDJEN E NGURTË TË FJALËVE

Një ditë ndoshta
Që nesër
Vjen një kohë kur ne
Nuk do të jemi në jetë
Vetëm letrat tona të dashurisë
Do të frymojnë si njeriu

Do i lexoj dikush i treti ose i katërti
I cili kurrë nuk ka dëgjuar
Asnjë fjalë për dashurinë
Mbase do ekzaltohet aq shumë
Sa që do humbë vetveten
Në labirintin e shkronjave

Në çastin kur e kupton
Gjendjen e gurtë të fjalëve
Do kuptoi më mirë
Se përse në jetë kurrë nuk dashuroi
Do kuptoi formën
Dhe brendinë e letrave të palexuara

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

MË MIRË ËSHTË KËSHTU

Mos më thuaj se i ke lexuar
Të gjitha letrat e mia
Mos
Mos thuaj asnjë fjalë tjetër
Lëre le të mbeten kujtimet në eter

Më mirë është kështu
Njeriu me kohë ndryshon
Kurse letrat mbetin si një testament
I historisë së pashkruar
Testament i një dashurie të pa përjetuar

Nëse nuk ke vend ku t'i lësh letrat
Të lutem vendosi diku
Në kujtesën tënde
Vendosi që nesër ose në një tjetër nesër
T'i lexosh nipave për dashurin e fjalëve

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

NGJAN ME PJEPRIN GJYSMË TË PRERË

Nëse ky dru vdes
Patjetër pas kësaj vdekjeje
Domosdo do lindin
Filizat me nga dy degë të reja
Lumenjtë asnjëherë nuk shterojnë
Derisa nuk mejnë shirat

Hëna në çdo kohë ëndërron
Dhe e ndërron
Formën e saj elipsoide
Një javë është e rrumbullakët
Kurse javën tjetër
Ngjan me pjeprin gjysmë të prerë

Kjo vazhdimësi kurrë nuk përfundon
Posa zhduket një cikël
Veç cikli tjetër paraqitet në hapësirë
Paraqitet si një lindje e re
Mbi kryqin
I cili mbiu nga shpirti i njeriut

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

JETA MA MËSOI GJUHËN E PANTOMIMËS

Nuk di asnjë fjalë e cila më drejton
Deri te portat e tua të hapura
Kë ta pyes
Me kë të bisedoj për prejardhjen time
Kryqi i kujt qante mbrëmë
Te varret e vithisura të shpirtit

Një lumë i çmendur
Asnjëherë nuk u ndal te dritaret e mendjes
Gjithmonë rrokulliseshin gurtë
Përpyetë shtigjeve të dallgëve
Sa herë që kërkova leje
Ju asnjëherë nuk ma dhatë fjalën

Më duket se një ditë
Do të filloj të flas me gishta
Jeta ma mësoi artin e pantomimës
Mësova edhe të heshti
Sepse heshtja ndonjëherë
Përmban në vete më shumë se njëmijë fjalë

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

BININ FJALËT MBI KOKËN TIME

Ishte një dimër i paparë
Degët e mështeknës
Veç kishin çelur disa lloje lulesh
Që asnjëherë nuk kanë lulëzuar
Nëpër xhamat e vitrinave

Një kukull prej plastike
Qante si një fëmijë i braktisur
Me të njëjtin vajë
Dënesnin edhe qeskat e najlonit
Kurse ky shi më duket si muzikë e lashtë

Këndonte edhe çatia
Një këngë të vjetër të ullukëve
Stërkalat binin nëpër xhama
Si boçat e gështenjave
Binin fjalët mbin kokën time

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

PËR TË KËNDUAR DUHET TË JESH POET

Lexoje letrën time të fundit
Nëse nuk gjen asgjë tjetër
Asnjë fjalë për të nesërmen
Domosdo do të takohesh me monotonin
E një jete
E cila kurrë nuk mësoi të këndoje

Për të kënduar duhet të jesh poet
Ose një piktor i cili i njeh
Të gjitha ngjyrat
Dhe vallëzon deri në mëngjes
Me brushën e thinjur
Mbi një basma ku notojnë ngjyrat e ylberit

Ju thashë për të kënduar
Duhet të keni shqisa tepër delikate
E jo si unë një njeri shurdhmemec
I cili sa herë deshi të këndoje
Nga pentagrami si të çmendura
Ikën të gjitha shenjat muzikore

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

NGA HESHTJA E JOTE KUPTOVA

Dridhja e zërit tënd
Më dukej si një muzikë arkaike
Kurse frymëmarrja e jote
Ngjante me puhinë e pranverës

Ku ishe ti kur në pranverë
Filluan të çelin aguliçet e verdha
Me qindra vjet trokita në dritaret e tua
Por kur nuk i hape kujtimet

Ende i mbaj në xhep letrat e shkruara
Të bardha dhe ato të kaltra
Secili zarf për mrekulli
Mund të krahasohej me qiellin e atdheut tim

Nëpër hartat e vjetra të mendjes
I shfletova të gjitha kujtimet
I preka duart dhe ëndrrat tona
Kurse aguliçet në çdo kohë i ndërruan ngjyrat

Kur të pyeta se ku isha mbrëmë
Ti mbete pa asnjë fjalë
Nga heshtja e jote kuptova
Se sa shumë u ngjan aguliçeve

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

MES NESH KISHTE VETËM NJË STINË

Të lutem dil nga kjo lojë
Dil dhe më prit te baladat e lashta
Sonte dua të jem vetvetja ime
Kurse nesër
Sërish do të të pranoj
Në ëndrrën time të pa ëndërruar

Ka kohë që e gdhenda emrin tënd
Në murin e kujtesës
Dhe asnjëherë më
Nuk lejova
Të largohesh tok me zogjtë
Mes nesh kishte vetëm një stinë

Të kam thënë dhe sërish po të them
Ne nuk jemi zogj shtegtarë
Kemi lindur me mija vjet
Para baladave të lashta
Dhe këtu do të vdesim
Me ëndrrat dhe zhgjëndrrat tona

Më prit pra më prit te portat e shpresës
Sepse unë domosdo një ditë
Do të kthehem ta preki ëndrrën e së kaluarës
Të preki me majat e gishtërinjve
Ashtu siç preknin dikur rrezet e para të diellit

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

KURSE LETRAT PREJ DRURI

Të kam thënë se letrat e tua
Janë letra prej druri
Shkruar në fshehtësinë
E dashurisë së një balade

Ishte një kohë e brishtë
Nga parmakët e dritareve
Si loti i shiut
Pikonin djersët e xhamave

Ti me një fustan ngjyrë portokalli
I ngjaje portokajve në kopsht
Kurse te portokallishtat
Vallëzonin gjinkallat e kaltra

Dielli mbi kokën e qiellit
Recitonte poemën e dashurisë
Kurse letrat prej druri
Era i lexonte në kujtesën e saj
Prishtinë, 16 janar 2017

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

ORA NA SHIKONTE ESËLL

Cakërrime gotash
Gëzuar
Pranë nesh kotet tavolina e dehur
Për kë të ngrehim sonte dolli
Për kë e dashur

Sa shpejt paska ikur nata
Uroj që të vonohet mëngjesi
Të kemi kohë edhe për një puthje
Gëzuar pra në heshtje
Të mos ja prishim gjumin tavolinës

Dhe sërish përsëritja
E një tjetër nate
Tjetër lloj cakërrimesh
Le të vallëzojnë karriget e dehura
Në ëndrrën e tavolinës

Ora na shikonte esëll
Me një elegancë të padëgjuar
Lëviznin akrepat
Lëviznin kah e nesërmja
Gëzuar për nesër e dashur

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

DUART E MIA TË KRISURA

Të thashë se sonte është koha
T’i përkëdhelim drutë
Nën pemët e çmendura
Si gjithmonë
T’i ledhatojmë gjokset e vashave

Është koha kur duart tona
U ngjajnë kuajve të egër
Që nëpër shpirtin e hapësirës
Galopojnë
Luadheve të kuqe

Nuk ndalen as atëherë
As në paraqitjen e hënës së re
Drutë e mi të mirë
Duart e mia të çmendura
Që s’dinë të ndalen asnjëherë

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

SONTE S'KA DASHURI

Sonte nuk është koha e gjumit
Ne nuk do të flemë
Do rim zgjuar
T'i numërojmë të gjitha yjet
Kah bien në tokë

Mund t'i prekim meteorët
Dhe vrapin e galaktikave
Ne e harruam urrejtjen
Sonte s'ka dashuri
Le t'i numërojmë vetëm yjet

Më prek
Preke të lutem ashtin tim
Dëgjoje zërin e tokës
Dëgjoje se si jehon
Në zgërbonjën e shpirtit

Sonte s'ka dashuri
Mjafton t'i shikojmë
Kah bien yjet
Ajo rrugë e largët qiellore
Sa afër na duket sonte

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

I PENGONTE FLUTURIMI I FLUTURËS

Ajo ishte një krijesë pa kohë
I mungonte e sotmja
Po ashtu edhe e nesërmja
Nuk dinte se çfarë të bëj
Me duart e saja të brishta

I pengonte çdo gjë që lëviz
Zëzëllima e mizës i dukej
Si hukamë deti
I pengonte fluturimi i fluturës
Mbase edhe vetvetja

Kur e pyetëm një ditë
Se çfarë nuk i pengon
Ajo nuk dha asnjë përgjigje
I ngjante gurit të murrme
Vetëm heshte

Në fillim e shikonte fundin
Që asnjëherë nuk përfundonte
I parapëlqenin zbrazëtitë
Andaj shikonte si e babëzitur
Boshllëkun e hapësirës

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

HAPNI PORTAT E MBYLLURA

Askush nuk trokiti
Më shumë se unë
Në dyert e mbyllura të baladave
Njëqind vjet mbeta mbrapa
Dhe ende jam duke trokitur

Hapni portat e mbyllura
Të dal nga ky ferr
Te retë më presin lejlekët
Edhe njëqind vjet të tjerë
Dua të fluturoj në zhgjëndërr

Ku e fshehët çelësin e kujtesës
Ju lutem
Hapni portat e mbyllura
S'jeto het dot kështu
Në këtë errësirë ku vdes drita

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

ME XHELOZI E MBAJE FRONIN

Fare mirë më kujtohet
Kur mbi lëkurën tende së skuqur
I prekëm yjet
I prekëm djersët joshëse
Në çastin kur e zbuluam hartën e dashurisë

Pa asnjë pengesë më të vogël
I kalova relievet
Që pëlcitnin si kripa në zjarr
Pëlcitnin nga shëndeti
Mollët e pjekura në degët e shpirtit

Ti ishe si një perëndeshë
Kokëfortë
Me sa xhelozë e mbaje fronin
Ishe më krenare se çdo krenari
Nga sytë e tua fluturonin zogjtë e bardhë

Dhe ia dhamë stomit
Dolëm në breg pa i lagur këmbët
Vetëm lëkura e jote e njomë
Pëlците nën hijen e mështeknës
Që ngjante me një hartë të përsosur të dashurisë

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

NË FILLIMIN E NJË UDHE

Gjithmonë kam thënë
Dhe sërish po të them
Sikur të mos kishe qenë ti
Unë kurrë nuk do isha
Ky njeri që jam sot

Së bashku ecëm një rrugë të gjatë
I kaluam të gjitha shtigjet
E pa kaluara
Të etur e të uritur
I dolëm përballë trishtimit të jetës

Asnjë stuhi nuk na e ndali rrugën
Ishim të denjë
Për çdo sakrificë
Sa herë që na u djersitën flokët
Në shpirtin e erës mbollëm nga një plep

Dhe ja ku jemi në fund të rrugës
Ose mirë me thënë
Në fillim të një udhe të re
E cila vazhdimësinë e saj e gjen
Te filizat e pinjollëve që vijnë

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

JU MERITONI MË SHUMË

Nuk kam aq shumë për të të dhënë
Kam shumë pak fjalë
Mes zëzëllimës dhe dashurisë
Ti meritoni më shumë
Se sa që mundem
Të të japi
Në këto çaste delikate

Pa ty unë jam vetëm një kufomë
Një britmë
Që del nga krateri i shpirtit
Por me ty
I ngjaj një shkëmbi
Frymëmarrja ime pranë teje
Shndërrohet në uragan

Ti je ADN-ja ime
Forca e një shkëmbi që s’thyeret
Me ty ndjehem njeri
Titan i pamposhtur
Në betejat e jetës
Ti je fillimi i ardhmërisë sime

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

POR DO MBËRRI ME DASHURI

Tani jam në fund të maratonës
Edhe pak rrugë më ka mbetur
Deri në cak
Besoj se do të mbërri
Forca më ka tradhtuar
Por gjithsesi do të mbërri me dashuri

Askurrë nuk më kanë penguar
Metrat e fundi
Bile kanë qenë edhe më provokues
Do ia dalë edhe kësaj maratone
E nëse mbërri të dalë mbanë
Do e ngrehim si dikur dollinë e dashurisë

Domosdo që nuk ka dështim
Në këtë rrugë të gjatë
Do i shkulim rrapet deri në rrënjë
Për ta arrirë qëllimin
S'do zgjedhim mjete
Ne gjithsesi duhet të mbërrimë në cak
Prishtinë 17 janar 2017

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Disa kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, kryesisht me poezi, që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën “Pionieri” më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe të pendës, themeloi grupin letrar “Lulëkuqet e Kosovës”. Në kuadër të punës së këtij grupi letrar, qe botuar përmbledhja “Ngjyra e kohës”, në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetatat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Muresha. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 – 1995, nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.

Jeton dhe krijon në Prishtinë.

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

BOTIME TË AUTORIT

1. “Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4. “Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëdarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
10. “Thirrje e gjakut”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu” Kastriot 2008

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
- 18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

23. "Hyji në Prekaz", poezi,"Qendra e Kulturës", Kastriot, 2010.
24. "Sinorët e hinores", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. "Don Kishoti dhe Rosinanti", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
- 26."Zjarri i dashurisë", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. "Kur likenet vallëzojnë", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. "Ditari në vargje", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. "Tingujt që nuk përfundojnë", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
- 30."Shtegu i mallit", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. "Korniza e thyer", Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. "Zgjimi i gjëmës", Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
- 33."Vallja mistike", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
34. "Merre kodin", Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
- 35."Letër atdheut" poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011

- 41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
50. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
- 75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012

77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013

79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.

87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

- 89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
- 91.”Krakëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 94.”Psalm i harruar ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
- 95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. “Stina asnjënëse”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

102. “Një grusht dashuri”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

- 115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia
Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia
Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
- 123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese
“TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “ Nëpër brigjet e kujtesës” Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 133.“Më mirë një gjysmë ëndrrë ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
- 135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
- 136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
138. “Nuk i them uinë dot kësaj liri” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
140. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
- 141.“Kumritë prej deltime”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

- 142.“Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.
- 143.“Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
- 144.“Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017
- 145.“Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
- 146.“Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
- 147.“Një stinë delikate”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
- 148.“Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
- 149.“Ishim të lumtur si gjinkallat”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
- 150.“Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
- 151.“Telat e shirave ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
- 152.“Një stuhi prej bryme”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2018
- 153.“Sonte s’ka dashuri ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri

Përmbajtja:

Cikli i parë

Thyheshin hejet e degëve

Larg janë të mirat prej jush

Thanë se do të na vrasin

Më duket se kthim nuk kishte mbrapa

Ishte ndalur ora në mesnatë

Nga zëri im zbritën mjegullat

U ngrinë edhe gurtë

Poetët kurrë nuk vdesin

Ditët e kësaj bote të shthurur

Pikonte një dimër i acartë

Janë dehur rrënjët e pjergullave

Ajo mbi një kep prej akulli

Fjalët janë të tepërta sonte

Drurët i kërcasin dhëmbët

U përngjajnë lejlekëve të sëmurë

Kopshti dukej lakuriq

Ishte shtrirë në djepin tim

Në ballinën perëndimore

Ose vendosnin afishe

Ngjajnë me zërin e natës

Thyheshin hejet e degëve

Nga prapashpina i dëgjuam

Kur Ballkani tinëzar

Në emër të cilit Zot

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

Cikli i dytë

Fluturuan përballë vdekjes

Kudo kontejner të boshatisur

Pranë jush zgërdheshej errësira

E gratë kujdesen për ushqimin e qenve

Koha është të mbyllen e jo të hapen varret

Njerëzit si gladiatorët modern

Pa i larë duart çohen të uritur

Si çadrat në Fushën e Mëllenjave

Mos harroni se ferri i juaj

Mashtruesit e të gjitha llojeve

U betuat në kryqin e juaj

Mallkimi

Kurse nëpër llagëme si dru dimri

Përpos lehjes së egër të yjeve

Si shpirti dhe dashuria e juaj

Rrapi kryeneç si gjithmonë

Asgjë tjetër nuk na duhet

Nën këmbët e ushtarëve

Nuk i bie në dorë të askujt

Thirrmat e atdheut për luftë

Po na ngufat kjo lakuriqësi

Dukeshin lakuriq si zogjtë e ngrirë

Njeriu gjithmonë ecën

Imazhet e ikjes ishin trishtuese

Fluturuan përballë vdekjes

Adem Zaplluzha –Sonte s’ka dashuri

Marshojmë pa sholla nëpër errësirë
Nuk dua vdekje më të bukur
Uria po i gërryen muret e mendjes
Ndizni ju lutem të gjitha llambat

Cikli i tretë
Sonte s’ka dashuri

Gjendjen e ngurtë të fjalëve
Më mirë është kështu
Ngjanë me pjeprin gjysmë të prerë
Jeta ma mësoi gjuhën e pantomimës
Binin fjalët mbi kokën time
Për të kënduar duhet të jesh poet
Nga heshtja e jote kuptova
Mes nesh kushte vetëm një stinë
Kurse letrat prej druri
Ora na shikonte esëll
Duart e mia të çmendura
Sonte s’ka dashuri
I pengonte fluturimi i fluturës
Hapni portat e mbyllura
Me xhelozie e mbaje fronin
Në fillimin e një udhe
Ju meritoni më shumë
Por do mbërri me dashuri

Adem Zaplluzha –Sonte s'ka dashuri